

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Syri" i Iranit në Ngushticën e Hormuzit! Pse SHBA-të e kishin shënjestruar prej kohësh ishullin Larak – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/syri-i-iranit-ne-ngushticen-e-hormuzit-pse-shba-te-e-kishin-sh-enjestruar-prej-kohesh-ishullin-larak/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 05:16:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	31 gusht 2026, 07:46:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	87992f0739362422a43e79ef81203ea357b7ea19bc9eca50d99d00446687725e
TEKSTI	60da4eb6ebef16af40cb781b639f74ff4941506ee87fc86908872d06d50ac306
PAMJA	1f8dcb617bc35ab18a0af292a88c0c4ae1100b6bc7dc1b569f58ebbe5d5bce44

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f1118ac2f08c220a78a016f0ada4867a5617fbfc8cd885ab6f39edd4a4d89a31
E MËPARSHMJA	27f87da2b689089a44e7097676ad825467bb5b8629f1d9610d33827f83994fe0
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f1118ac2f08c220a78a016f0ada4867a5617fbfc8cd885ab6f39edd4a4d89a31>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Tensionet mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit janë rikthyer në qendër të vëmendjes pas rreth një muaji, pasi forcat amerikane goditën objektiva ushtarake në ishullin Larak, një pikë e vogël në hartë, por me rëndësi të madhe strategjike për Teheranin.

Ishulli Larak ndodhet në Ngushticën e Hormuzit dhe pozicioni i tij pranë rrugëve kryesore detare e bën atë një nga pikat më të rëndësishme të Iranit për monitorimin dhe kontrollin e lëvizjes së anijeve në hyrje të Gjirit Persik.

Të dielën, forcat amerikane bombarduan dy pozicione për lëshimin e raketave në ishull. Ky ishte sulmi i parë amerikan ndaj objektivave brenda Iranit që prej fundit të korrikut.

Teherani u zotua se do të përgjigjej dhe, më pas, lëshoi tetë raketa balistike drejt bazave amerikane në Jordani. Sipas raportimeve, të tetë raketat u interceptuan.

Laraku, në një nga pikat më të ndjeshme të Hormuzit

Me një sipërfaqe prej rreth 49 kilometrash katrorë, ishulli Larak ndodhet në Ngushticën e Hormuzit, pranë portit strategjik të Bandar Abbasit. Ai shtrihet në një pozicion që i jep Iranit pamje dhe akses të drejtpërdrejtë ndaj rrugëve detare në hyrje të Gjirit.

5 Elbasani nuk ranë egnatia peson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

Iranian forces attacked King Hussein and Muwaffaq Salti Air Bases in Jordan tonight in response to the US strike on Larak Island.

A US source told Fox that “nearly all” incoming ballistic missiles were intercepted, with no significant impacts. pic.twitter.com/TtpFx1O9vm — OSINTtechnical (@Osinttechnical) August 30, 2026

Laraku ndodhet në lindje të ishullit Qeshm dhe në jug të ishullit Hormuz, në një nga segmentet më të ngushta të zonës.

Pozicioni i tij është veçanërisht i rëndësishëm pasi nëpër këto ujëra kalojnë anije tregtare dhe cisterna që transportojnë naftë dhe produkte energjetike. Çdo ndërprerje e trafikut në Ngushticën e Hormuzit mund të ketë pasoja për tregjet ndërkombëtare të energjisë.

“Syri” i Iranit mbi rrugët detare

Pikërisht vendndodhja e Larakut e ka shndërruar ishullin në një lloj “syri” të Iranit mbi Ngushticën e Hormuzit.

Afërsia me korridoret kryesore detare u mundëson forcave iraniane të monitorojnë lëvizjen e anijeve dhe trafikun detar në këtë zonë strategjike. Për këtë qëllim, Irani ka vendosur në ishull radarë dhe infrastruktura të tjera për mbikëqyrjen e trafikut detar.



Por roli i Larakut nuk kufizohet vetëm te survejimi.

Në ishull ndodhet gjithashtu një bazë ushtarake e Gardës Revolucionare Islamiqe, ndërsa aty gjenden edhe infrastruktura për transportin dhe eksportin e naftës, të ndërtuara që prej fundit të viteve 1980.

Forcat e Gardës Revolucionare përdorin gjithashtu portet e ishullit për të ushtruar kontroll mbi anijet që kalojnë në zonë, përfshirë vendosjen e tarifave të kalimit.

Pse e goditën SHBA-të Larakun?

Rëndësia ushtarake dhe gjeografike e ishullit shpjegon pse Laraku mund të jetë një objektiv i rëndësishëm në çdo përshkallëzim të konfliktit rreth Ngushticës së Hormuzit.

Të dielën, SHBA-të pretenduan se kishin vërejtur përgatitje nga ana e Gardës Revolucionare për vendosjen ose lëshimin e minave detare në Ngushticën e Hormuzit.

Kjo u përdor si justifikim për goditjen e dy pozicioneve të lëshimit të raketave në Larak.

Sulmi amerikan dhe përgjigjja iraniane kanë rikthyer frikën për një përshkallëzim më të gjerë në Gjirin Persik, veçanërisht në një zonë që konsiderohet jetike për transportin global të naftës.

Ngushtica e Hormuzit mbetet kështu një nga pikat më të rrezikshme të përplasjes mes Washingtonit dhe Teheranit, ndërsa çdo përshkallëzim ushtarak në këtë korridor mund të ndikojë jo vetëm sigurinë rajonale, por edhe tregjet globale të energjisë.

#Iran

#SHBA

#sulme



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh

BOTA

Sulm me dron ndaj një anijeje ruse në Detin...

Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë

BOTA

Trump i kërkon Zelenskyt të...

Xhuljana Zhuleku · 2 orë më parë

BOTA

Tragjedi! Përmbysët anija me pasagjerë,...

Xhuljana Zhuleku · Dje 23:17



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.